

LIGJ
Nr.7589, datë 15.7.1992

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7546, DATË 6.1.1992 "PËR ADMINISTRIMIN E
TATIMEVE E TAKSAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"**

Në mbështetje të neneve 13 dhe 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7546, datë 6.1.1991 në nenin 1, paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:
"Organe tatimore janë Drejtoria e tatimeve në Ministrinë e Financave e të Ekonomisë dhe organet e saj në komuna, bashki e rrethe që varen nga kjo drejtori."

Neni 2

Pas nenit 1 shtohen nenet 1 a dhe 1 b me këto përmbajtje:

Neni 1 a "Pagat, shpenzimet për mbajtjen e administratës tatimore, si dhe shpërblimet e ndryshme për të, përballohen nga buxheti i shtetit. Për këtë Drejtorisë së Tatimeve i lihen në dispozicion 0,5 për qind e të ardhurave vjetore të parashikuara në buxhetin e shtetit."

Neni 1 b "Kur të ardhurat totale të buxhetit realizohen në masën 85 për qind e lart, punonjësve të organeve tatimore u jepet një shpërblim deri në 10 paga mujore në vit. Gjykimi i shpërblimit për punonjësit e organeve tatimore në komuna, bashki e rrethe, bëhet nga Drejtoria e tatimeve në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë, kurse për punonjësit e kësaj drejtorie nga ministri i Financave dhe Ekonomisë".

Neni 3

Në nenin 4 pas fjalëve "legjislacionit" shtohet fjala "shqiptar".

Neni 4

Në nenin 8 bëhen këto ndryshime:

- Në shkronjën "a", pas fjalëve "saktësinë e" shtohen fjalët "veprimeve ekonomike llogaritjen e tatimeve dhe..."
- Në fund të shkronjës "b" shtohen fjalët "ekonomike dhe realizimin e tatimeve".
- Në shkronjën "c", pas fjalës "subjekt" shtohen fjalët "për problemet që lidhen me tatimet".

Neni 5

Neni 10 ndryshohet si vijon:

"Organet tatimore janë të detyruara të ruajnë fshehtësinë e të dhënave dhe të dokumenteve tatimore të tyre, si dhe të subjekteve ekonomike". Këto mund t'u jepen vetëm organeve të drejtësisë dhe organeve të Kontrollit të Shtetit ose organeve a personave që përcaktohen në marrëveshjet me shtetet e tjera".

Neni 6

Neni 11 ndryshohet si vijon: "Agjentët e tatimeve e taksve detyrohen të kryejnë të gjitha

veprimet që lidhen me mbledhjen, mbajtjen dhe evidencimin e tatimeve në përputhje me legjislacionin në fuqi për tatimet".

Neni 7

Pas nenit 11 shtohen nenet 11 a dhe 11 b me këtë përmbajtje:

Neni 11 a "Agjentët e tatimeve e taksave për mosmbajtjen në rregull të dokumentacionit për evidencimin e tatimeve e taksave kur nuk formon vepër penale dënohen me gjobë nga 3000 gjer në 10000 lekë. Të drejtën e gjobës e kanë punonjësit e organeve tatimore në komunë, bashki e rrethe dhe në Drejtoritë e tatimeve.

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve nga dita e shpalljes ose njoftimit të tij, përkatësisht te kryetari i zyrës së tatimeve e taksave në rreth ose te drejtori i Drejtorisë së tatimeve në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë, akti i të cilëve është i formës së prerë".

Neni 11 b "Për shumat e tatimit dhe të taksës të llogaritura gabim agjentët e taksave përgjigjen materialisht në masën e dënimit të shkaktuar."

Neni 8

Neni 12 ndryshohet si vijon: "Çdo subjekt që ushtron veprimtari ekonomike dhe ka fituar zotësinë për të vepruar, regjistrohet në organet tatimore brenda 10 ditëve nga data e fillimit të zotësisë për të vepruar."

Neni 9

Neni 13 ndryshohet si vijon:

"Personat fizikë e juridikë vendas a të huaj, pasi të kenë fituar zotësinë juridikë për të vepruar, brenda 10 ditëve duhet të paraqiten në organet tatimore për t'u regjistruar e pajisur me certifikatën përkatëse, e cila u jep atyre të drejtën për të ushtruar veprimtarinë në të gjithë vendin.

Personat fizikë vendas e të huaj duhet të paraqesin në organet tatimore këto dokumente: kërkesën me shkrim ku të përfshihen emri, mbiemri i plotë i tij, adresa e plotë e qendrës ku ushtron veprimtarinë dhe e banimit, llojin e veprimtarisë që do të ushtrojë si dhe vendimin e gjykatës që i jep zotësinë për të vepruar.

Personat juridikë vendas e të huaj paraqesin në organet tatimore këto dokumente: kërkesën me shkrim ku përfshihen emri, mbiemri i plotë dhe i shkurtuar i personit juridik, llojet në hollësi të veprimtarisë ekonomike që do të kryejë, format e organizimit të veprimtarisë, marrëdhëniet e varësisë së personit juridik, vendimin e gjykatës që i jep zotësinë për të vepruar, si dhe, kur është rasti, aktin e krijimit dhe statutin e tyre. Subjektet me kapital të përbashkët dhe zyrat e përfaqësimit paraqesin edhe autorizimin e Ministrisë së Tregtisë dhe të Bshkëpunimit Ekonomik me Jashtë.

Personat fizikë dhe juridikë vendas e të huaj i paraqesin dokumentet e mësipërme në dy kopje dhe, pasi firmosen e vulosen nga organet tatimore e subjektet ekonomike, mbajnë një kopje secili".

Neni 10

Pas nenit 13 shtohet neni 13a me këtë përmbajtje:

Neni 13 a "Kur subjektet ekonomike nuk paraqiten për t'u regjistruar në organet tatimore brenda 10 ditëve nga dita e fitimit të zotësisë juridike për të vepruar, dënohen me gjobë 100 lekë për çdo ditë të tejkalimit të afatit".

Neni 11

Në nenin 14 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Detyrimi për pagimin e tatimeve e taksave për të gjitha subjektet fillon nga koha e regjistrimit të tyre në organet tatimore".

Neni 12

Pas nenit 14 shtohet neni 14 a me këtë përmbajtje:

"Të ardhurat e buxhetit të shtetit që rrjedhin nga tatimet e taksat, kanë përparësi në radhën e pagesave në bankë.

Për detyrimet buxhetore të paderdhura në afat nga subjektet, organet tatimore kanë të drejtë të vendosin urdhërblokimi për nxjerrjen e tyre. Urdhërblokimi është titull ekzekutiv për organet bankare.

Organet tatimore, kur e shohin të arsyeshme, për mosderdhje në afat të detyrimeve buxhetore e të gjobave, kanë të drejtën të bëjnë çrregjistrimin e subjekteve dhe t'u japin çertifikatën përkatëse".

Neni 13

Neni 15 ndryshohet si vijon:

"Personat juridikë a fizikë, vendas a të huaj, që ushtrojnë veprimtari ekonomike, detyrohen të mbajnë dokumentacionin dhe të nxjerrin bilancin financiar në përputhje me ligjin për kontabilitetin".

Neni 14

Neni 16 ndryshohet si vijon:

"Kur tatimi i llogaritur mbi fitimin për personat juridikë ose mbi të ardhurat për personat fizikë ka diferenca me atë të derdhur, rillogaritja e tij bëhet brenda 15 ditëve nga data e konstatimit".

Neni 15

Në nenin 17 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Asnjë kërkesë ankimore e tatimpaguesve nuk merret në shqyrtim nga organet tatimore, në rast se nuk është shoqëruar me dokumentin e pagesës së tatimit, taksës ose gjobës së vënë".

Neni 16

Pas nenit 17 shtohen nenet:

- Neni 17 a, "Pala e huaj në subjektet me kapital të përbashkët ose plotësisht të huaj, kur nuk i përmbahet kushteve të kontratës e ndërpret veprimtarinë e saj dhe transferon kapitalet materiale e monetare, detyrohet të paraqitet brenda 5 ditëve në organet tatimore dhe të pajiset me vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve ndaj buxhetit. Organet doganore dhe ato bankare lejojnë transferimin e kapitalit të këtyre subjekteve, vetëm kur ato janë pajisur me vërtetimin e mësipërm".

- Neni 17 b, "Organet doganore detyrohen të shënojnë në fletën e zhdoganimit të importit dhe në daljen e eksportit, numrin e certifikatës, datën dhe vendin ku është regjistruar subjekti.

Kur subjektet nuk kanë dokumentin e mësipërm, organet doganore nuk bëjnë zhdoganimin e mallit dhe njoftojnë policinë financiare të rrethit të cilit i përket subjekti".

- Neni 17 c, "Për efekt të pagimit të tatimeve e taksave veprimtaritë ekonomike që ushtrojnë partitë politike dhe shoqatat trajtohen si person juridik privat".

- Neni 17 ç, "Për efekt të mosaplikimit të tatimit mbi qarkullimin ose të akcizës mbi mallrat që eksportohen, eksport do të quhet sasia e mallit që del nga territori i vendit".

- Neni 17 d, "Organet tatimore kanë të drejtë të kontrollojnë rregullshmërinë e llogaritjes, nxjerrjes dhe derdhjes së tatimeve dhe taksave në çdo hallkë ku ato realizohen, si për mallrat e importit, ashtu dhe për ato të vendit e për taksat".

- Neni 17 dh, "Për tatimet me kuotë fikse, për taksat dhe për pagën minimale të patatueshme, Drejtoria e tatimeve në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë ka të drejtë të bëjë korrigjime në përputhje me indeksin mesatar vjetor të inflacionit dhe të pagave.

- Neni 17 e, "Kur subjektet ekonomike mbyllen, shpërbëhen, ndryshojnë veprimtarinë e tyre, ose pësojnë ndryshime të tjera thelbësore, detyrohen të njoftojnë brenda 5 ditëve organet tatimore për të bërë veprimet përkatëse. Mosparaqitja në afat dënohet me gjobë 200 lekë, për çdo ditë vonesë".

Neni 17

Pas nenit 19 shtohet neni 19 a me këtë përmbajtje: "Të drejtën e vendosjes së gjobave sipas neneve 13 a dhe 17 "e" të këtij ligji e kanë punonjësit e tatimeve në komuna, bashki e rrethe dhe punonjësit e Drejtorisë së tatimeve në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë.

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim, brenda 5 ditëve nga dita e shpalljes ose e njoftimit të tij, përkatësisht te kryetari i zyrës së tatimeve e taksave në komunë e bashki, te kryetari i degës së tatimeve e taksave në rreth ose te drejtori i Drejtorisë së tatimeve në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë, akti i të cilëve është i formës së prerë".

Neni 18

Në nenin 20, paragrafi i parë, fjalët "te kryetari i komitetit ekzekutiv të rrethit" të zëvendësohet me fjalët "te kryetari" i zyrës së tatimeve e taksave në komunë e bashki, ose te kryetari i degës së tatimeve e taksave në rreth".

Në paragrafin e dytë, pas fjalës "Financave" shtohen fjalët "Ekonomisë".

Neni 19

Ky ligj hyn në fuqi 5 ditë pas shpalljes së tij.

Shpallur me dekretin nr.259, datë 20.7.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.